



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:042551  
Datë: 14.09.2018  
Numri i dokumentit: 00121830

*P.nr. 547/16*

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **S.M.** nga Gjilani, për shkak të veprës penale, **Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 paragrafi 1 KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.747/16, e datës 28.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik, më datën 11.09.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndersa me datë 14.09.2018 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari S.M.**, nga babai N. dhe nëna N., e lindur P., i lindur më datë ..., në fsh. ..., K. e Gjilanit, jeton Gjilan, në rr. “ ... ” nr. ..., i martuar, baba i shtatë fëmijëve, pronar i restorantit “ ... ” në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, më datën 29.11.2015, në kohë të pavërtetuar, në lokalit e tij, është konstatuar se në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që nga ana e jashtme njehsori elektrik me nr. ..., e ka shpuar një vrimë dhe si pasojë e këtij veprimi disku i njehsorit dhe tabela e të dhënave teknike janë të gërvishura, me ç’rast KEDS-in, Distribuimi në Gjilan e ka dëmtuar në vlerë prej 19.167.65 €,

- me çka ka kryer veprën penale, **Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-së**, andaj Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

## **DËNIM KUMULATIV, ME GJOBË DHE ME KUSHT**

*Të akuzuarit S.M., Dënim me Gjobë në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguajë ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe Dënim me Burg – me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili denim nuk do te ekzekutohet nese i akuzuari ne periudhen verifikuese prej 1 (nje) viti nuk kryen veper tjeter penale, ne te kunderten Gjykata denimin me kusht do ta revokoje*

*Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) €, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

*Pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr. 747/2016, e datës 28.04.2016, kundër të akuzuarit S.M., për veprën penale, **Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-së** dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.*

*Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, në fjalën përfundimtare deklaroi se meqë i akuzuari e ka pranuar fajsinë në këtë shqyrtim gjyqësor dhe pranimi është bërë me vullnet, duke i kuptuar pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajsisë, në tërësi mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve që ajo i përmban, ashtu që, propozon që të pandehurinta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritor ndërsa, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, t'i vlerësojë të gjitha rrethanat, si lehtësuese edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.*

*I akuzuari S.M., deklaroi se është penduar për kryerjen e veprës penale dhe i premtonte gjykatës që më nuk do ta përsërisë ndonjë vepër penale, andaj, kërkon nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, pranimin e fajsisë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori faktin se këto vepra penale janë bërë dukuri shumë e shpeshtë kohëve të fundit, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, duke qenë e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.*

*Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:042551, 14.09.2018**

**G j y q t a r j a**

---

Luljete Shabani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimt të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.